



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr.

4615

Prishtinë,

Dt. 27.09.2022

RAPORT I VLERËSIMIT TË PROJEKT PROPOZIMIT

| | |
|---|---|
| FAKULTETI | Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore |
| Departamenti/ Programi | Biologji |
| Projektpropozimi | "Vlerësimi i gjendjes mjedisore në deponinë e hirit, përreth termoelektranës A, përmes parametrave të stresit oksidues te bimët <i>Papaver rhoeas</i> dhe <i>Echium vulgare</i> " |
| Kandidati | Jetmir Zabelaj |
| | |
| | |
| Vlerësimi i projekt propozimit | |
| <p>Në Kosovë burim kryesorë energjetikë janë termocentralet Kosova A dhe Kosova B, puna e të cilave mbështetet në djegien e thëngjillit. Të dy këto termocentrale po thuajse iu ka kaluar koha e përdorimit të tyre në kuptimin teknologjik dhe si të tilla konsiderohen si ndotësit më të mëdhenj mjedisor, jo vetëm për shkak të gazrave që lirohen si rezultat i djegies së thëngjillit por edhe të hirit cili grumbullohet në deponi në afërsi të tyre. Këto deponi jo vetëm që prishin imazhin e pejsazhin e natyrës, por janë të dëmshëm edhe në përmbajtje. Prandaj përzgjedhja e këtyre lokaliteteve në hulumtim është e qëlluar. Përmes këtij hulumtimi kandidati synon të vlerësojë gjendjen mjedisore të deponisë së hirit duke përdorur bimët si biomonitore. Në fakt bimët në hulumtime mjedisore përdoren gjerësisht në mënyrë efektive ngase janë të lirë dhe të natyrshëm. Më tutje kandidati, në projektpropozimin e paraqitur duke shqyrtuar literaturën adekuate paraqet fakte në lidhje me rëndësinë e parametrave të stresit oksidues (sasia e grupeve të tiorit, peroksidimi i lipideve dhe sasia glutathion S transferazës) të përgjeshur për të vlerësuar nivelin e ndotjes në zonat e hulumtuara.</p> <p>Në projektin e propozuar për temë të masterit kandidati po ashtu përshkruan në detaje punën dhe ecurinë</p> | |

eksperimentale te hulumtimit, dhe në mënyrë korrekte dhe qartë përcakton objektivin hulumtues si vijon:

- 1.Përcaktimi i tioleve totale dhe tioleve të lidhura për proteina
- 2.Përcaktimi i aktivitetit të enzimit GST (Glutathion S-transferase) dhe
- 3.Përcaktimi i MDA-së (Malondialdehidit) si produkt i peroksoidimit të lipideve.

PERFUNDIMI DHE PROPOZIMI


Projekt propozimi për punim të temës së masterit të kandidatit **Jetmir Zabelaj** konsiderohet me vlera shkencore dhe me rëndësi aplikative, meqenëse e ndërlihdë ndotjen e mjedisit me mekanizmat mbrojtës antistres, përmes te cilëve mund pastaj do të mund të konkludohet për nivelin e ndotjes së lokaliteteve të hulumtuara. Nisur nga formulimi i hipotezave të bazuara nga literatura e shqyrtuar, përcaktimi për parametrat hulumtues, metodat dhe modelin eksperimentues, mendojmë se kandidati do ti arrijë objektivat e parapara në qëllimin e hulumtimit. Andaj duke u bazuar në premisat e lartshënuara, komisioni për vlerësimin e përshtatshmërisë se temës masterit me titull: **“Vlerësimi i gjendjes mjedisore në deponinë e hirit, përreth termoelektranës A, përmes parametrave të stresit oksidues te bimët Papaver rhoeas dhe Echium vulgare”** të kandidatit **Jetmir Zabelaj** e vlerëson pozitivisht dhe i propozon KMSH të Departamentit të Biologjisë dhe të FSHMN-së të pranoj këtë projekt propozim të temës së masterit dhe të lëshoj vendimin përkatës.

Prishtinë, 27. 09. 2022


UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HABAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCËVE MATEMATIKE-NATYRORE
PRISHTINË

| | | | |
|--------------------------|-------|-------|-------|
| Pranuar me: 27. 09. 2022 | | | |
| Nj. org. | Numër | Sasia | Vlera |
| 07 | 4615 | 4 | — |


Komisioni:

1. 

Prof. asoc. dr. Hazbije Sahiti – mentor/

2. 

Prof. dr. Kemaajl Bislimi – anëtar/

3. 

Prof. dr. Elez Krasniqi – anëtar/